

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021*

18.03.2021
Ora 16:20

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU, PS, BD, PSD, PLDSH, PBK, LN**
- **Koalicione:** **ABEOK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme publike në rendin e ditës kemi dy çështje. Projektvendimi që ka të bëjë me rezultatin e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 dhe pika e dytë ka të bëjë “Për lirimimin dhe emërimin e anëtarëve të disa KZAZ-ve në Qarkun e Shkodrës, Qarkun e Tiranës, Qarkun Korçë dhe në Qarkun Gjirokastër. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me zhvillimin e procedurave të shortit për të përcaktuar renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit dhe miratimin e rezultatit të këtij shorti. I japim fjalën Sekretarit të KQZ-së për të administruar procedurën e zhvillimit të shortit. Ndoshta është e nevojshme të bëhet një sqarim paraprak për procedurën.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021*

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendimin nr.10, dt.11.03.2021 ka vendosur procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Procedura përcaktohet në nenin 4 të këtij projektvendimi dhe është konceptuar në dy faza. Faza e parë është ajo e parashortit dhe faza e dytë, ajo e shortit. Faza e parashortit ka të bëjë me rradhën e tërheqjes së goglave nga subjektet zgjedhore që përcaktohen me parashortin i cili zhvillohet sipas kësaj procedure. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short. Në një shirit letre të bardhë është vendosur numri i subjekteve zgjedhore. Një person i autorizuar nga administrata përzieen goglat në të dy enët transparente dhe tërheq gogllën që ka emrin e subjektit dhe në enën tjetër që ka numërat nga 1 deri tek numri i subjekteve pjesëmarrëse në short. Emri i subjektit që del nga goglat që janë shënuar me emrin e subjekteve dhe numëri që del nga ena transparente me goglat që është shënuar numëri korespondojnë këto.., numëri i subjektit do të tërheqë i pari, i dyti, ose i treti sipas rradhës në renditjen e partive. Pastaj procedura e dytë e shortit është: Përfaqësuesi i partisë politike i cili është përcaktuar në renditje se ç’rradhë do të ketë në tërheqjen e gogllës, tërheq në emër të partisë në enën transparente të fazës së dytë të shortit dhe numëri që do të tërheqë do të përcaktojë renditjen e subjektit në fletën e votimit. Fillojmë procedurën e parashortit, përfaqësuesi i caktuar nga administrata do të ...

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë paqartësi nga përfaqësuesit e partive politike për procedurën?! Nuk kemi! Vazhdojmë!

Z. Y. Merkaj: Kemi 12 shirita letre ku është vendosur emri i subjekteve të cilat do të tregohen nga përfaqësuesi i administratës së KQZ-së.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

Përfaqësuesi i administratës së KQZ-së: Tregon 12 shiritat e letrës ku janë shkruar emrat e subjekteve zgjedhore që do të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të dt.25.04.2021.

Z. Y. Merkaç: Shiriti i letrës ku është shkruar Partia Bindja Demokratike do të futet në goglën e cila është me ngjyrë, peshë dhe formë të njejtë. Partia Balli Kombëtar, Partia Aleanca Demokracia e Re, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, Partia Nisma Thurje, Partia Socialiste, Partia Socialdemokrate, Partia Lëvizja e Re, Partia Lëvizja për Ndryshim, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët dhe Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim. Pra, në një enë transparente u vendosën shiritat me emrat e subjekteve, 12 subjekte zgjedhore. Në enën tjetër transparente do të vendosen shiritat e letrës nga numëri 1 deri tek numëri 12 në goglat të cilat janë me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë. Nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, nr.11, nr.12. (Futen të 12 numërat në goglat e më pas në enën tjetër transparente).

Fillon procedura, personi i autorizuar do të përziejë goglat ku janë shiritat e subjekteve zgjedhore fillimisht.

Nga hapja e goglës së parë lexohet shiriti “Partia Bindja Demokratike”. Nr.2. në rradhën e tërheqjes. Përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike do të tërheqë i dyti tek ena tjetër numrat që do të vendosen për të përcaktuar renditjen në fletën e votimit...

Z. I. Celibashi: Atëherë, Partia Bindja Demokratike do të jetë e dyta për të tërhequr numrin për renditjen në fletën e votimit.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021*

Z. Y. Merkaç: Partia Balli Kombëtar - nr.11. Atëherë, përfaqësuesi i Partisë Balli Kombëtar do të jetë i njëmbëdhjeti që do të tërheqë goglën me numrin e subjekteve.

Partia Socialdemokrate - nr.4. Atëherë, përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate do të jetë i katërti që do të tërheqë goglën me numrin e subjekteve.

Partia Socialiste - nr.5. Përfaqësuesi i Partisë Socialiste do të jetë i pesti që do të tërheqë goglën me numrin e subjekteve.

Partia Lëvizja për Ndryshim - nr.10. Përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate do të jetë i dhjeti që do të tërheqë goglën me numrin e subjekteve.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim nr.6. Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim do të jetë i gjashti që do të tërheqë goglën me numrin e subjekteve.

Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët do të jetë e shtata në rradhën e tërheqjes.

Partia Nisma Thurje do të jetë e dymbëdhjeta në rradhën e tërheqjes.

Partia Aleanca Demokracia e Re do të jetë e teta në rradhën e tërheqjes.

Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare do të jetë e para në rradhën e tërheqjes së goglave.

Partia Lëvizja e Re do të jetë e treta në rradhën e tërheqjes së goglave.

Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim do të jetë e nënta në rradhën e tërheqjes.


Vazhdojmë me procedurën e fazës së dytë të shortit.

Z. I. Celibashi: Atëherë, rradhë është kjo që do të lexojmë:

E para do të tërheqë Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare;

E dyta, Partia Bindja Demokratike;

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

- E treta, Partia lëvizja e Re;
- E katërta, Partia Socialdemokrate;
- E pesta, Partia Socialiste;
- E gjashta, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- E Shtata, Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët;
- E teta, Partia Aleanca Demokracia e Re;
- E nënta, Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim;
- E dhjeta, Partia Lëvizja për Ndryshim;
- E njëmbëdhjeta, Partia Balli Kombëtar;
- E dymbëdhjeta, Partia Nisma Thurje.

Z. Y. Merkaç: Atëherë, në enën transparente do të vendosen shiritat me numrat nga 1 deri tek 12-ta. Do të futen në gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Sipas rradhës që lexoi Komisioneri, përfaqësuesit e partive politike do tërheqin goglat. Numri që del nga goglat do të jetë dhe renditja në fletën e votimit të subjekteve zgjedhore.

Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare është i pari që do të tërheqë goglën.

Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare – tërheq goglën – nr.3;

Z. Y. Merkaç: Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare do të jetë e treta e renditur në fletën e votimit. Përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike ka rradhën për të tërhequr.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

Përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike – tërheq – nr.4.

Z. Y. Merkaj: Partia Bindja Demokratike do të renditet e katërta.

Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Re. Meqenëse nuk është i pranishëm përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Re, një person i autorizuar nga administrata do të tërheqë në emër dhe për llogari të Partisë Lëvizja e Re.

Përfaqësuesi i administratës së KQZ-së – tërheq – nr.8.

Z. Y. Merkaj: Partia Lëvizja e Re do të renditet e teta. Përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate ka rradhën e tërheqjes.

Përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate – tërheq – nr.1.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialdemokrate do të jetë e para në Fletën e votimit. Sipas parashortit e pesta në rradhën e tërheqjes është Partia Socialiste.

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Le të tërheqë administrata.

Z. Y. Merkaj: Përfaqësuesi i Partisë Socialiste autorizon administratën të tërheqë në emër dhe për llogari të saj.

Përfaqësuesi i administratës së KQZ-së – tërheq – nr.12.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialiste do të jetë e dymbëdhjeta e renditur në fletën e votimit. Rradhën për tërheqje e ka Partia Socialiste për Integrim.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: I nderuar zoti Kryetar, ne autorizojmë zotin Frenkli Shatku që është votues për herë të parë këtë vit, që të tërheqë gogllën në interes të partisë sonë.

Z.Frenkli Shatku – tërheq – nr.6.

Z. Y. Merkaj: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim do të jetë e renditur e gjashta në fletën e votimit. Përfaqësuesi i Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët do të tërheqë gogllën.

Përfaqësuesi i Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët – tërheq – nr.5.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët do të jetë i pesti i renditur në fletën e votimit. Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokracia e Re do të tërheqë gogllën.

Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokracia e Re – tërheq – nr.10.

Z. Y. Merkaj: Partia Aleanca Demokracia e Re do të jetë e dhjeta e renditur në fletën e votimit. Rradhën për tërheqje e ka Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim.

Z.L.Nuraj, përfaqësues i PD-së – tërheq – nr.9.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



19

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

Z. Y. Merkaj: Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim do të jetë e nënta e renditur në fletën e votimit. Partia Lëvizja për ndryshim ka rradhën për të tërhequr goglën.

Z.D.Prenga, përfaqësues i LN-së – tërheq – nr.11.

Z. Y. Merkaj: Partia Lëvizja për Ndryshim do të renditet e njëmbëdhjeta e renditur në fletën e votimit. Rradhën e tërheqjes e ka përfaqësuesi i Partisë Balli Kombëtar.

Z.E.Alimadhi, përfaqësues i PBK - tërheq – nr.2.

Z. Y. Merkaj: Partia Balli Kombëtar do të jetë e renditur e dyta në fletën e votimit. E fundit për të tërhequr goglën është Partia Nisma Thurje.

Përfaqësuesi i Partisë Nisma Thurje – tërheq – nr.7.

Z. Y. Merkaj: Partia Nisma Thurje do të jetë e shtata e renditur në fletën e votimit. Për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit duke qenë se në çdo qark ka nga një kandidat, sipas Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit do të renditen të fundit në fletën e votimit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit, atëherë rezultatet e shortit kanë përcaktuar këtë renditje të partive politike në fletën e votimit:

Nr.1 Partia Socialdemokrate;

Nr.2 Partia Balli Kombëtar;

Nr.3 Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare;

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



20

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

Nr.4 Partia Bindja Demokratike;

Nr.5 Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shqipërisë dhe Konservatorët;

Nr.6 Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

Nr.7 Partia Nisma Thurje;

Nr.8 Partia lëvizja e Re;

Nr.9 Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim;

Nr.10 Partia Aleanca Demokracia e Re;

Nr.11 Partia Lëvizja për Ndryshim;

Nr.12 Partia Socialiste;

Ky ishte rezultati i shortit të cilin në cilësinë e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet e miratoj me aktin përkatës, faleminderit për kontributet për këtë pikë të rendit të ditës.

Vendimi nr.168

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021*

**18.03.2021
Ora 16:43**

RENDI I DITËS

Projekvendim “Për lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ-së nr.02, KZAZ-së nr.04, KZAZ-së nr.29, KZAZ-së nr.30, KZAZ-së nr.37, Qarku Tiranë, KZAZ-së nr.74, Qarku Korçë, KZAZ-së nr.77, Qarku Gjirokastër”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PS, PSD, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me disa ndryshime në përbërjen e Komisioneve të Administrimit Zonal të Zgjedhjeve.

Z. Y. Merkaj: Bazuar nën 32 paragrafi “2” i Kodit Zgjedhor, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ka kërkuar lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.30, Qarku Tiranë, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.02, Qarku Shkodër, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.04, Qarku Shkodër, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.29, Qarku Tiranë, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.77, Qarku Gjirokastër. Partia Demokratike në datën 17.03.2021 ka kërkuar lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.37, Qarku Tiranë, lirim dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.77, Qarku Korçë. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se është në

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.03.2021**

përputhje me nenin 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor dhe i propozojmë Komisionerti Shtetëror të Zgjedhjeve t'i pranojë propozimet.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë diskutime nuk kemi. Bazuar nenit 19 paragrafi "1" shkronja "ç" dhe "2" si neni 30, 31 dhe 32 paragrafi "2" shkronja "d" të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Lirimini nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr.2, KZAZ-së nr.4, Qarku Shkodër, KZAZ-së nr.29, KZAZ-së nr.30, KZAZ-së nr.37, Qarku Tiranë., KZAZ-së nr.74, Qarku Korçë, KZAZ-së nr.77, Qarku Gjirokastrë sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të emërojnë anëtarët e KZAZ-së nr.2, nr.4, nr.29 dhe nr.30 të KZAZ-ve të Qarku Shkodër nr.37 të Qarkut Tiranë, KZAZ-së nr 74 Qarku Korçë KZAZ-së nr.77, Qarku Gjirokastrë, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Pikë tjetër në rendin e ditës. Edhe një herë përcaktojmë se kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit renditen të fundit në çdo rast. Ky është parashikimi i Kodit. Në Qarkun e Tiranës është një kandidat i cili do të jetë i renditur i 13-të.

Z. Y. Merkaj: Po, duke qenë se është një kandidat do të renditet i 13-të.

Z. I. Celibashi: Seanca mbyllet, faleminderit!

Vendimi nr.169

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino**

